



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan Republika e
Kosovës www.uni-gjilan.net
tel: 0280390112

RAPORT PËRMBLEDHËS PËR STUDENT NË MOMENTIN (PARA) DIPLOMIT

Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi

Fitore Malaj-Abdyli

Table of Contents

1. Hyrje.....	3
2. Metodologjia e Hulumtimit.....	3
2.1 Qëllimi I Hulumtimit.....	3
2.2 Metodat e hulumtimit	3
3. Rezultatet e Hulumtimit.....	3
3.1 Informata për rrjedhën e hulumtimit	3
3.2 Analiza e pyetësorve	4
3.2.1 Rezultatet e vlerësimit të Stafit Administrativ të UKZ-së nga studentët	4
4.Perfundimet dhe Rekomandime.....	5

1. Hyrje

Këshilli për Mbikëqyrje, Cilësi dhe Vlerësim ka konstatuar që është e nevojshme që të realizohet një pyetësor për studentët të cilët janë para diplomimit në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjiilan. Pyetësoni është hartuar nga Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi më pas është vendosur në platformën SMU, ku studentët përpara së të tërheqin dokumentet nga Universiteti janë të obliguar që të plotësojnë këtë Pyetësor.

Ky pyetësor përmbledhës shërben si një pasqyrë e performancës së studentit para se të marrë diplomën e tyre, duke ofruar një vlerësim të përgjithshëm të arritjeve të tyre akademike dhe të angazhimit në fushën e studimit.

2. Metodologjia e Hulumtimit

2.1 Qëllimi i Hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë me identifikimin e problematikave të mundshme gjatë përvojës së studentëve në UKZ.

Nga ky hulumtim kemi arritur të nxjerrim cilat aftësi dhe njohuri kanë fituar studentët gjatë tërë kohës së studimeve në UKZ.

Rekomandimet e dala nga ky vlerësim do t’u shërbejnë Universitetit për të reflektuar mbi gjetjet e hulumtimit

2.2 Metodot e hulumtimit

Hulumtimi u realizua kryesisht përmes metodës kuantitative dhe instrumenteve që janë në funksion të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave.

Në kuadër të kësaj kemi plasuar pyetësorin në platformën SMU, në momentin që studenti aplikon që të marrë diplomën e përfundimit të Fakultetit, I detyrueshëm është pyetësorin që duhet ta plotësojnë në fund.

3. Rezultatet e Hulumtimit

3.1 Informata për rrjedhën e hulumtimit

Në kuadër të punëve të Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi (ZZHA) është paraparë që përveç vlerësimit të rregullt të Stafit Akademik, nga ana e studentëve të bëhet edhe vlerësimi i Stafit Administrativ, kështu që në bashkëpunim me Menaxhmentin e Lartë të UKZ-së si dhe Këshillin për Mbikëqyrje të Cilësisë dhe Vlerësimit (KMCV) kemi hartuar pyetësorin sipas Shkallës së Likertit, ku studenti për secilin konstatim është dashur të rumbullaksojë 1,2,3,4 ose 5 (5=pajtohem plotësisht; 4=pajtohem; 3=nuk e di; 2=nuk pajtohem; 1=aspak nuk pajtohem).

Për hartimin e Raportit të Vlerësimit si dhe publikimin ka punuar kryesisht Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi në konsultim me KMCV-në.

POHIMET	Vlera Mesatare
1 Gjatë studimeve kam zhvilluar të menduarit kritik dhe analitik	4.33
2 Kam fituar njohuritë specifike për vendin e punës	4.23
3 Mendoj që kam zhvilluar aftësitë për zgjidhjen e problemeve	4.31
4 Kam zhvilluar aftësi për punë kërkimore dhe hulumtuese	4.27
5 Kam fituar njohuri për mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave	4.35
6 Kam zhvilluar aftësitë komunikuese në komunikimin verbal dhe me shkrim	4.34
7 Kam fituar njohuri për përdorimin e gjuhës angleze	3.95
8 Kam fituar njohuri në përdorimin e teknologjisë informative	4.19
9 Kam fituar shkathtësi për punë ekipore dhe nën presion të kohës	4.28
10 Sjellja etike dhe vlerat morale janë parime të studimeve në UKZ	4.45
Mesatarja e përgjithshme	4.28

Tabela 1. Rezultatet e pyetësorëve të studentëve para diplomimit

3.2 Analiza e pyetësorve

3.2.1 Rezultatet e vlerësimit të Stafit Administrativ të UKZ-së nga studentët

Këto të dhëna vlerësojnë aftësitë dhe njohuritë që studenti ka fituar gjatë studimeve në UKZ. Bazuar në vlerësimet e tyre: Studenti ka zhvilluar një të menduar kritik dhe analitik të mirë 4.33, si dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve 4.31, duke treguar një nivel të lartë vlerësimi për këto aspekte.

Gjithashtu, ka fituar njohuri specifike për fushën e punës së tij/të saj 4.23 dhe është zhvilluar në hulumtimin dhe interpretimin e të dhënave, si dhe në aftësitë komunikuese 4.27, të cilat vlerësohen si të larta.

Në aspekte të tjera, si njohuritë në përdorimin e gjuhës angleze dhe teknologjisë informative 3.95, studenti ka vlerësime të mira, por jo aq të larta sa në fushat e mëparshme.

Sjellja etike dhe vlerat morale vlerësohen si shumë të rëndësishme dhe të përforcuara gjatë studimeve në UKZ 4.45.

Mesatarja e përgjithshme është e lartë 4.28, tregues i një performace të mirë të studentit në të gjitha fushat e vlerësuara, duke reflektuar një përparim të qëndrueshëm dhe të mirë në përgjithësi gjatë kohës së studimit në universitet.

4.Përfundimet dhe Rekomandime

Bazuar në vlerësimet e larta që studenti ka dhënë për aftësitë dhe njohuritë e fituara gjatë studimeve në UKZ, disa rekomandime mund të jepen për të përmirësuar ose shtuar vlerën e tyre:

Përmirësimi i njohurive në gjuhën angleze: Mund të rekomandohet përmirësimi i njohurive në gjuhën angleze përmes kurseve të specializuara, trajnimeve ose praktikave që inkurajojnë përdorimin e gjuhës në një nivel më të lartë të kompetencës.

Përdorimi i teknologjisë informative: Zhvillimi i mëtejshëm i aftësive në përdorimin e teknologjisë informative mund të arrihet përmes kurseve shtesë, trajnimeve praktike, ose projekteve që përdorin mjetet teknologjike për të përmirësuar njohuritë në këtë fushë.

Përdorimi i metodave të hulumtimit dhe analizës: Inkurajimi për të eksploruar më shumë metoda të hulumtimit dhe analizës përmes projekteve të veçanta, trajnimeve shtesë apo praktikave që mund të shtojnë aftësitë në këtë drejtim.

Aftësitë e komunikimit: Trajnimet për komunikimin efektiv, si në mënyrën verbale ashtu edhe atë me shkrim, mund të ndihmojnë në përmirësimin e aftësive komunikuese në mënyra të ndryshme dhe në kontekste të diversifikuara.

Përmirësimi i aftësive ekipore dhe nën presion të kohës: Aktivitete ekipore dhe projektet që përfshijnë kohë të kufizuar mund të ndihmojnë në përmirësimin e aftësive për të punuar në grup dhe në situata ku koha është faktor vendimtar.

Përmirësimi i njohurive të specializuara dhe të detajuara në fushën e punës: Një fokus i shtuar në njohuritë e specializuara dhe zhvillimi i tyre në mënyrë që të jenë më të përshtatshme dhe të përmirësojnë përputhjen me nevojat e tregut të punës.

Këto rekomandime mund të ndihmojnë në përmirësimin e aftësive dhe njohurive që studenti ka vlerësuar, duke i ofruar atij/a aspekte të shtuara për të zhvilluar dhe përforcuar aftësitë e tij/të saj në fushën e studimit dhe në përgjithësi në jetën profesionale.

